

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Peleshi lexon deklaratën e Kuvendit: Në solidaritet me Kosovën dhe ish-krerët e UÇK-së
ADRESA	https://lapsi.al/peleshi-lexon-deklaraten-e-kuvendit-ne-solidaritet-me-kosoven-dhe-ish-kreret-e-uck-se-i1093946
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:28:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:22:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	199b5808dc5aef800a6d7e62d847f5f7730cba6a67fb172dc54d064e3534c86f
TEKSTI	894cbb75a2c4efb50b64e17c2e72678fa274a552a4c70829e6aa754cff928666
PAMJA	b38b921536dc65ae441c86cde721fcbbf4e1421961e48d3a1e8f6af0936288fc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7ff3e7d812a83f932cd94ca7de78aa4600f72878ed3c94f20c3e92e3a74a3786
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7ff3e7d812a83f932cd94ca7de78aa4600f72878ed3c94f20c3e92e3a74a3786>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Peleshi lexon deklaratën e Kuvendit: Në solidaritet me Kosovën dhe ish-krerët e UÇK-së

L LAPS1.AL • 17 SEPTEMBER 2026



Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, ka lexuar në Kuvend deklaratën në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ish-pjesëtarëve të saj.

Në deklaratë, Kuvendi i Shqipërisë shpreh bindjen se lufta e UÇK-së ishte për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Peleshi deklaroi se Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje për të relativizuar krimet e regjimit të Slobodan Millosheviçit. Sipas deklaratës, e vërteta historike për luftën në Kosovë mbetet e palëkundur.

Kuvendi angazhohet gjithashtu për drejtësi për viktimat e luftës dhe zbardhjen e krimeve të kryera ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Në këtë kuadër, është kërkuar edhe koordinimi i veprimeve me Kuvendin e Kosovës dhe adresimi i shqetësimeve përmes rrugëve institucionale.

Kryetari i parlamentit Niko Peleshi: Kuvendi i Shqipërisë qëndron kundër përpjekjeve për të relativizuar krimet e Millosheviçit. E vërteta historike mbetet e palëkundur: UÇK luftoi për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Kuvendi i Shqipërisë beson në pafajësinë e krerëve të UÇK-së.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që të kërkojë drejtësi për viktimat e luftës në Kosovë, që të zbardhen krimet e luftës në Kosovë kundër popullit shqiptar, të koordinojmë veprimet me Kuvendin e Kosovës që të çojmë shqetësimet në rrugë institucionale.

DRAFT DEKLARATË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Kuvendi i Shqipërisë shpreh indinjatën e thellë dhe mosdakordësinë e plotë me një vendim që e konsideron thellësisht të padrejtë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi i Shqipërisë rithekson një të vërtetë historike që nuk mund të relativizohet: lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Ishte

ide



Andi Bushati: Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati



Gënjeshtër e rezortëve elitare
Blendi Kajsia

MOTITIRANA

28°C

KËMBIMIEURO

91.65

aktuale

08:06

Seancë brenda, protestë jashtë/Qytetarët zhvendosen para Kuvendit

08:02



Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes dhe për të fituar të drejtën për të jetuar të lirë në vendin e vet. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, dhunës, spastrimit etnik dhe genocidit të kryer nga regjimi i Slobodan Milosheviçit. Pa luftën dhe sakrificën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pushtimit gjakatar serb, historia e çlirimit të Kosovës nuk mund të kuptohet. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës dhe e rrugës që çoi drejt çlirimit, lirisë dhe pavarësisë së saj. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga lufta për çlirim dhe nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetësisë së saj.

Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli. Nuk mund të zhbëjë karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës apo të barazojë agresorin me viktimën. Nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së.

Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për standardet e dyfishta në trajtimin e së kaluarës së përgjakshme të rajonit. Nderimet publike dhe shtetërore që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte, si edhe glorifikimi i figurave të lidhura me gjenocidin dhe spastrimin etnik, përfshirë Ratko Mladiçin, cenojnë kujtesën e viktimave, pengojnë pajtimin dhe bien ndesh me vlerat europiane.

Kuvendi qëndron kundër çdo përpjekjeje të Serbisë dhe Rusisë për ta instrumentalizuar politikisht këtë proces, për të relativizuar krimet e regjimit të Miloševićit dhe për të delegjitimuar luftën çlirimtare, pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë qëndron në solidaritet të plotë me Kosovën, popullin dhe institucionet e saj, si dhe pranë Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe familjeve të tyre.

E palëkundur mbetet bindja jonë në pafajësinë e tyre dhe po aq e palëkundur mbetet e vërteta historike: UÇK-ja luftoi për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Kuvendi pret që të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që:

Në të gjitha forumet ndërkombëtare të denoncojë krimet e regjimit serb të Slobodan Milosheviçit në Kosovë, përfshirë aktet gjenocidale, krimet e luftës dhe dhunën seksuale gjatë luftës; të kërkojë drejtësi për viktimat dhe të dënojë mungesën e angazhimit të autoriteteve serbe për zbardhjen e këtyre krimeve, vendosjen e përgjegjësisë dhe garantimin e drejtësisë për viktimat.

Të koordinojë veprimet me Kuvendin e Kosovës, dhe i bën thirrje të dyja Qeverive tona që gjithashtu të koordinojnë veprimet, me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së



"Marre", Ramën e bëjnë copë në rrjetet sociale pas dënimit të Hashim Thaçit



VIDEO/ Del nga SPAK arkitekti që projektoi vilën e Belinda Ballukut



Departamenti amerikan i Shtetit i vë kapakun, përshëndet dënimin e ish-krerëve të UÇK

Të keshilluara



Gjykata bllokoi qeverinë për aeroportin e Vlorës/ Pacolli: Duam dialog për vazhdimin e punës!

Behgjet Pacolli ka reaguar pas vendimit të Qeverisë shqiptare për ndërprerjen e kontratës së koncesionit për Aeroportin e Vlorës.



Apeli rrëzon Ilir Metën, e lë në burg

Apeli i Posaçëm ka rrëzuar kërkesën e Ilir Metës, i cili kishte kundërshtuar vendimin e shkallës së parë në...



“KAYO skandal i paparë”/ Berisha: Bëhet trafik armësh, e shëmtuar për një vend të NATO-s



Studentët në Prishtinë nisin protestat, kërkojnë drejtësi

Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë ditën e sotme, ndërsa po prote...



Eurodeputetja greke shpërthen ndaj Von der Leyen: Na mbytët me emigrantë, taksa e burokraci!

Një përplasje e fortë është shënuar dje në Parlamentin Europian, gjatë debatit për gjendjen e Bashkimit Europian, ...



Berisha: Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë

Kryetari i PD-së Sali Berisha akuzoi presidentin e Serbisë Alekssandër Vuçiç dhe ‘argatin’ e këtij të fundi...



Protesta në Prishtinë/ Studentët kërkojnë drejtësi në ish-

krerët e UÇK-së



Berisha akuza socialistëve në Kuvend: Jeni bërë ushtarë të Padronit dhe Yeffet!

Nga foltorja e Kuvendit lideri i PD-së Sali Berisha kërkoi lirim të menjëhershëm të protestuesve të ndaluar dhe ndëshkimin...



Ndryshim rrënjësor në RTSH: Identitet i ri, programe të reja dhe pesë superprodhime

Radio Televizioni Shqiptar prezantoi këtë të mërkurë, në një event të mbajtur në hollin "Gjon Simoni"...



Grabitën me dhunë dy pika karburanti në Bulqizë, identifikohet njëri prej autorëve

Dy pika karburanti janë grabitur me dhunë gjatë natës në Bulqizë dhe Fushë-Bulqizë, ndërsa Policia ka identifikuar...

Me sytë katër



22:48


PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin për...



PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

28:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

28:36



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43

SPORT

→ Të tjerë artikuj



13:22

I mori Grudën FSHF-së. Klopp shpërthen për



14:05

Broja, Hysaj... po Strakosha? Dilemat e Maran dhe lista e



13:53

Te Juventus ishte 'bidon', Jonathan David vendos

zbulimin e listës në media: “Është patetike të fitosh jetesën kështu”

Kombetares për 4
ndeshjet e Nations
League

Tekordin historik të
Atletico: në Spanjë
paralajmërojnë Alvarez



13:45

Messi bën historinë gjatë
vetës para nisjes së ndeshjes



12:16

Stadiumi i Levantes
përmbyhet pas stuhisë



11:24

Jashari i tërbuar pas
Mikel Arteta (Përsëri)



10:18

Europa League, Juventus
debuton ndaj NEC:
Sallottini dhe...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.